



Embassy
of the Republic of Poland
in Tirana

Të Ndëruar,

Agjencia Kombëtare e Shkëmbimit Akademik të Republikës së Polonisë, NAWA, në datën **20 maj 2021** do të shpallë çeljen e seleksionimit të aplikimeve në kuadër të programit të bursave “Stefan Banach”, adresuar studentëve nga vendet në zhvillim, përfshirë edhe Shqipërinë.

Programi në fjalë ofron:

- studime të nivelit II me bursë 1500 PLN në muaj përgjatë gjithë vitit akademik (3 - 4 semestra)
- studimet do të jenë në drejtimet e poshtëshënuara:

a) shkencat inxhinjieriko-teknike

b) shkencat agrare

c) shkencat ekzakte dhe ato të natyrës

Opsionale mund të jenë edhe studime në shkencat humane dhe ato sociale ku bëjnë përjashtim studimet filologjike.

Studimet mund të kryhen në gjuhën polake, ose atë angleze.

Për rastin e parë Programi parashikon edhe bursë për kursin 9-mujor për mësimin e gjuhës polake (1700 PLN në muaj) si dhe kursin veror të gjuhës (1500 PLN) që më së shumti do të jetë për studentët që kanë mbaruar vitin I në gjuhën angleze.

Përfitues të Programit do të jenë studentët e vitit të fundit në Bachelor, por edhe ata që i kanë përfunduar studimet e nivelit I jo më herët se viti 2019.

Niveli i zotërimit të gjuhës polake për aplikantët duhet të jetë minimalisht B1, ndërsa për gjuhën angleze së paku B2.

Vlerësimi i aplikimeve do të ketë në bazë mesataren aritmetike të rezultateve në Bachelor.

Ambasada e Republikës së Polonisë në Tiranë

Rruga e Durrësit 123
1001 Tirana

Phone: +355 445 100 20
Fax: +355 422 333 64
tirana.amb.sekretariat@msz.gov.pl
www.gov.pl/albania-en